

Thirrje për aplikim për dhënien e bursave në kuadër të projektit “Fuqizimi i të rriturve, të rinjve dhe fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes edukimit” i cili financohet nga Danish Refugee Council (DRC) dhe implementohet nga Teach For Kosova

Teach For Kosova hap konkurs për dhënien e bursave për **nxënës të shkollave të mesme të larta** që vijnë nga komunitetet **Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë**. Bursat planifikohen të jepen për nxënës të cilët i kanë braktisur mësimet pas vitit të parë ose të dytë akademik.

Thirrja për dhënien e bursave për nxënës të shkollave të mesme u dedikohet nxënësve të cilët kanë braktisur shkollimin dhe me anë të kësaj burse do t’u paguhet arsimi për të rritur për përfundimin e vitit akademik. Qëllimi i bursave është që t’i motivojnë të rinjtë ta përfundojnë shkollën e mesme përmes lehtësimit të barrës së shpenzimeve.

Shuma të cilën do ta përfitojnë nxënësit është **600 Euro** për vit akademik. Nga ky program bursë do të përfitojnë **5 nxënës**.

Inkurajohen të aplikojnë nxënësit të cilët për çfarëdo arsye kanë ndërprerë shkollimin e mesëm.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Certifikatën e përfundimit të shkollës fillore
- Certifikatën e klasave të përfunduara të shkollimit të mesëm (nëse ka të përfunduar ndonjë)
- Kopja e letërnjoftimit.

Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në email adresën info@teachforkosova.org.

Afati për dorëzim të aplikimeve është deri më datë **15 Shkurt 2022**, ora 17:00.